

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA” – PRISHTINË

FAKULTETI JURIDIK

Tema: “Marrëveshjet e kredive për konsumatorë sipas legjislacionit të Kosovës dhe Shqipërisë”.

ABSTRAKT

Tema: “Marrëveshjet e kredive për konsumatorë sipas legjislacionit të Kosovës dhe Shqipërisë”, qëllimi kryesor pse kam zgjedhur të hulumtoj këtë temë ka qenë që të gjithë lexuesit në veçanti konsumatorët dhe të gjithë studiuesit e ardhshëm, përmes kësaj teme të marrin njohuri të mira për rolin dhe rëndësinë e kësaj teme. Rëndësia dhe fokusi më i madh i kësaj teme është dhënë në aspektin e hulumtimit të materialeve shkencore dhe ligjore të aspektit ekonomik, konkretisht tek marrëveshjet e kredive për konsumatorë me qëllim bazë për të sjellë prurje të reja në këtë lëmi.

Marrëveshjet konsumatore janë një element kyç në jetën e përditshme, sepse me vet faktin që këto marrëveshje janë në formë të shkruar e japin edhe efektin e vet juridik se për çka janë krijuar. Përmes këtij punimi është synuar që konsumatorët t’i kuptojnë dhe zbatojnë më lehtë të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga marrëveshjet e kredive për konsumatorë.

Në këtë punim diplome, janë trajtuar në mënyrë të detajuar: aspekti historik- zhvillimor i bankave, kuptimi i bankave, Banka Qendrore e Kosovës dhe funksionet e saj, shërbimet bankave komerciale, kreditë konsumatore roli dhe rëndësia e tyre, rregullimi ligjor i marrëveshjeve të kredive për konsumatorë sipas legjislacionit të Kosovës dhe Shqipërisë, aspekti krahasimor midis legjislacionit të Kosovës dhe Shqipërisë. Të gjithë këta tituj të cekur në punim janë ndarë edhe në nëntituj. Në fund të punimit janë ofruar disa përfundime dhe rekomandime.

Fjalët kyçe : Marrëveshjet e kredive, konsumatorë, legjislacioni, bankat, licencim.

Kandidatja : Arbenita Hussain